



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AUTORITETI PORTUAL DURRËS

Lenda: Shtojcë me Modifikime në Dokumentet Standarte të Tenderit

OPERATORËVE EKONOMIKË TË INTERESUAR

Mbështetur në Ligjin Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 42 dhe në VKM-në Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 62, për procedurën e prokurimit me REF-70453-09-01-2020, me objekt “Shërbimi i menaxhimit dhe operimit të Terminalit të Konteinerëve në portin e Durrësit tek operatorë portualë privatë të specializuar për 5 vjet” dhe fond limit 3.736.183.195 (tre miliardë e shtatëqind e tridhjetë e gjashtë milion e njëqind e tetëdhjetë e tre mijë e njëqind e nëntëdhjetë e pesë) lekë, pa TVSH,

➤ Në Dokumentet Standarte të Tenderit, bëhen ndryshimet, si vijon:

Në shtojcën 10, pika 3.1.1 “Kapacitetit ligjor/profesional i operatorëve ekonomikë”:

Ishte

“Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë themeluar në formën e personit juridik. Ofertuesi, përfshirë anëtarët e Bashkimit të Përkohshëm dhe ortakët e tij nuk duhet të jetë e regjistruar në vende të njohura si parajsa fiskale/offshore.

Ofertuesi duhet të paraqesë një deklaratë me anë të së cilës deklaron që nuk është i regjistruar në vende të njohura si parajsa fiskale/offshore.”

Bëhet:

“Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë themeluar në formën e personit fizik, juridik apo ent publik ose grup personash dhe/ose organesh të tilla, që ofrojnë në treg sipërmarrjen e shërbimeve të kërkuara. Ofertuesi, përfshirë anëtarët e Bashkimit të Përkohshëm dhe ortakët e tij nuk duhet të jetë e regjistruar në vende të njohura si parajsa fiskale/offshore.

Ofertuesi duhet të paraqesë një deklaratë me anë të së cilës deklaron që nuk është i regjistruar në vende të njohura si parajsa fiskale/offshore.”

Në shtojcën 10, pika 3.3.1 të “Kapaciteti teknik”:

Ishte

”1. Ofertuesi duhet të dëshmojë eksperiencë në kryerjen e shërbimeve të mëparshme, të ngjashme, gjatë secilit prej tri viteve të fundit lidhur me trajtimin e kontejnerëve në port/porte detare, për të paktën 40% e vlerës së volumeve në referencë të vlerës së përllogaritur të të gjithë kontratës.

Përmbushja e këtij kushti duhet të dëshmohet përmes dokumentacionit vërtetues të lëshuar nga autoritete publikë/autoritete portualë.”

Bëhet:

”1. Ofertuesi duhet të dëshmojë eksperiencë në kryerjen e shërbimeve të mëparshme, të ngjashme, gjatë tri viteve të fundit nga data e zhvillimit të tenderit lidhur me trajtimin e kontejnerëve në port/porte detare, për të paktën 40% e vlerës së përllogaritur të të gjithë kontratës që prokurohet.

Ofertuesi gjithashtu duhet të dëshmojë eksperiencë në kryerjen e shërbimeve të mëparshme, të ngjashme, gjatë tri viteve të fundit nga data e zhvillimit të tenderit lidhur me trajtimin e kontejnerëve në port/porte detare, për të paktën 40% të volumeve të përllogaritura të të gjithë kontratës që prokurohet, (40% e 664 265 TEU, d.m.th. 265 706 TEU.)

Përmbushja e këtij kushti duhet të dëshmohet përmes dokumentacionit vërtetues të lëshuar nga autoritete publikë/autoritete portualë, vërtetime të lëshuara nga një ent publik ose/dhe faturave tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.”

Në shtojcën 10, pika 3.2.1 të “Kapaciteti ekonomik dhe financiar”:

Ishte

“1. Ofertuesi duhet të dëshmojë se xhiroja e realizuar në seicilin nga tre vitet e fundit: 2017, 2018 dhe 2019, nuk është më e vogël se 40% e vlerës limit të kontratës (kontrata 5 vjecare) e përllogaritur në bazë vjetore.”

Bëhet:

“1. Ofertuesi duhet të dëshmojë se xhiroja mesatare e realizuar në tre vitet e fundit financiar 2017, 2018 dhe 2019, nuk është më e vogël se 40% e vlerës limit të kontratës që prokurohet (kontrata 5 vjecare) e përllogaritur në bazë vjetore.”

Në Seksionin 4, pika 4.2 “Kriteret e përzgjedhjes së fituesit” – “Propozimi teknik i specifikuar me pikët për çdo kriter”, pika 4:

Ishte:

“Plan i propozuar i Burimeve Njerëzore, duke përfshirë planin e organizimit, linjat e koordinimit dhe informimit dhe përshkrimin e detyruar të punës për çdo punonjës kyç. (Plani i Organizimit të Burimeve Njerëzore).

Program i propozuar për Sigurinë dhe Shëndetin në punë, dhe ndihmat sociale të stafit (Occupational Health, Safety and Welfare Program) i cili preferohet të jetë në përputhje se bashku me një afat kohor të detyrueshëm për t'u zbatuar.”

Bëhet:

“Plan i propozuar i Burimeve Njerëzore, duke përfshirë planin e organizimit, linjat e koordinimit dhe informimit dhe përshkrimin e detyruar të punës për çdo punonjës kyç. Gjithashtu, ky plan përfshin dhe CV-të e paraqitura, për të paktën 6 punonjës të kualifikuar në pozicione manaxheriale (drejtues terminali, drejtues për gatishmërinë teknike, etj.).

(Plani i Organizimit të Burimeve Njerëzore).

Program i propozuar për Sigurinë dhe Shëndetin në punë, dhe ndihmat sociale të stafit (Occupational Health, Safety and Welfare Program) i cili preferohet të jetë në përputhje se bashku me një afat kohor të detyrueshëm për t'u zbatuar.”

➤ **Afati kohor për dorëzimin dhe hapjen e kërkesave për pjesëmarrje, ndryshohet si vijon:**

• **Ishte:**

Data 22.09.2020, ora 10:00.

• **Bëhet:**

Data 02.10.2020, ora 10:00.